



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Komuna e Lipjanit: datë 22.07.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 20.07.2020, të parashtruar nga Operatori Ekonomik, NNP "CTA" SHPK nga Prishtina, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i qerdhes së fëmijëve në Fshatin Gadime" me Nr. të Prok: 613-20-2452-5-2-1

V E N D I M

I Refuzohet, kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik NNP "CTA" SHPK nga Prishtina të dt. 20.07.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i qerdhes së fëmijëve në Fshatin Gadime", me nr. të Prok: 613-20-2452-5-2-1

Vërtetohet Vendimi i AK për shpërblim me kontratë për Operatorin Ekonomik "ENGRUP" SHPK nga Prishtina i datës 15.07.2020 të publikuar në web-faqe të KRPP-së

1. **Mbetet në fuqi** Vendimi i AK për shpërblim me kontratë i publikuar me datë: 15.07.2020.
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të lartëpërmendur.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik NNP "CTA" SHPK nga Prishtina, me datë 20.07.2020 ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i qerdhes së fëmijëve në Fshatin Gadime" me nr. të Prok: 613-20-2452-5-2-1 ku në këtë aktivitet AK ka shpallur fitues OE "ENGRUP" SHPK nga Prishtina, **për shpërblim me kontratë**, të datës 15.07.2020 të publikuar në platformën elektronike e-prokurimi.

Operatori Ekonomik NNP''CTA''SHPK nga Prishtina, me datë. 20.07.2020 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i qerdhes së fëmijëve në Fshatin Gadime" Autoriteti Kontraktues, me datë 21.07.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pikat që oferta juaj është eliminuar janë:

1. Tenderi juaj është eliminuar për arsye se të kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional përketen stafit profesional vendim apo deklaratën për emerimin e menaxherit e keni në emer të inxhinierit të diplomuar të ndërtimtarisë-drejtimi konstruktiv, ndërsa sipas kërkesave të Autoritetit kontraktues duhet të jete inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë me drejtimin e arkitektures.
2. Po ashtu të kërkesa e kapacitetit teknik dhe profesional licencën e gjeodetit e keni me afat të skaduar.

Pretendimi nr 1

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

AK nuk ka kërkuar informata shtesë pasi që në staf kemi edhe inxhinjer të diplomuar të arkitektures të cilin mund ta caktojmë menaxher të kontratës pasi që kemi bërë gabim në vend që të caktojmë inxhinjerin e arkitektures kemi caktuar inxhinjerin e ndërtimit ku inxhinjeri i ndërtimit është me i thirrur në realizimin e projektit në fazën e ndërtimit se sa inxhinjeri i arkitektures

1. Pretendimi juaj i parë

Sqarim: Autoriteti Kontraktues pas vlerësimit të ofertave ka analizuar çdo kërkesë dhe çdo dokument që ju si OE keni dorëzuar në sistem për këtë projekt. Sa i përket gabimit nga ana e juaj në lidhje me vendimin e menaxherit, Autoriteti Kontraktues nuk ju ka kërkuar informata shtesë për arsye se sipas legjislacionit të prokurimit publik në fuqi kur mungon vendimi në këtë rast mund të kërkojnë informata sqaruese ndërsa në rastin tuaj vendimi ka qenë në dokumentacionin tuaj i cila nuk i ka plotësuar kërkesat e AK dhe nuk mund të kërkojnë informata sqaruese. Ndërsa sa i përket pretendimit tuaj se inxhinjeri i ndërtimtarisë me drejtimin konstruktiv është me i thirrur në realizimin e këtij projekti se sa ai i arkitektures ju si operator duhet të plotësoni kërkesat sipas kërkesave të AK të parapara me dosjen e tenderit dhe me njoftimin për kontratë. Ky pretendim i juaj është i **Pa Bazuar**

Pretendimi nr 2 AK nuk ka respektuar RREGULLAT dhe UDHËZUESI OPERATIV për PROKURIMIN PUBLIK kur mungon licenca apo data e skadimit AK duhet të kërkojë informata sqaruese poashtu është e specifikur edhe në nenin Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

2. Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

3. Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.
Licenca për gjeodetinë me validitet

2. Pretendimi juaj i dytë

Sqarim: Ky pretendim i juaj është i pa bazuar për arsye se sipas legjislacionit të prokurimit publik në fuqi kur mungon licenca mund të kerkohen informata sqaruese ndërsa në rastin tuaj licenca ka qenë në dokumentacionin tuaj me afat të skaduar e cila nuk i ka plotësuar kërkesat e AK dhe nuk mund të kerkohen informata sqaruese në këtë rast.

Pretendimi nr 3

Kapaciteti teknik dhe profesional.

Në njoftimin për kontratë dhe dosje tenderit është kërkuar : Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratat për projekte të ngjashme në vlerë prej 370,000.00 Euro në 3 (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë (në rast të grupit(konzorciumit) lideri duhet të ketë së paku 60% të kërkesës).

3. Pretendimi juaj i tretë

Sqarim. Autoriteti Kontraktues konsideron se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë e plotëson këtë kusht për arsye se edhe këto renovime janë punë të ngjashme për këtë projekt. Pretendimi i juaj në këtë pikë është i pa bazuar

Pretendimi nr:4

Numri i Nr i brendshëm është 613 020 045 521 e jo siq është shënuar në sigurimin e OE të shpallur fitues Nr i prokurimit 613-20-2452-5-2-1

4. Pretendimi juaj i katërt

Sqarim. Sa i përket numrit të brendshëm të sigurimit të tenderit të operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë autoriteti kontraktues konsideron se ky sigurim i plotëson të gjitha kushtet e përcaktuara sipas formës standarde pjesë e dosjes së tenderit për arsye se nuk është e domosdoshme që të vendosen të dy numrat e prokurimit, por mjafton vetëm njëri ashtu siq e keni edhe ju në ofertën tuaj këtë sigurim vetëm me nr të jashtëm. Pretendimi i juaj në këtë pikë është i pa bazuar.

Pretendimi nr 5

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale
KERKESA NGA AK Kerkesa 2. Staf i Profesional a) Min. Nje Inxhinier i diplomuar i arkitektures, sistemi 5 vjeqar ose master, Te caktohet edhe si menagjer per kete projekt, b) Min. Nje Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë - drejtimi konstruktiv, sistemi 5 vjeqar ose master c) Min. Nje Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë – drejtimi hidroteknik sistemi 5 vjeqar ose master, d) Min. Nje Inxhinier i diplomuar i elektrikoteknikes. sistemi 5 vjeqar ose master, e) Min. nje Inxhinier i diplomuar i makinerisë sistemi 5 vjeqar ose master, f) Nje gjeodet bachelor apo master te jete i paisur edhe licence per matje gjeodezike, g) Min Nje inxhinier bachelor apo master i diplomuar per menagjim te emergjencave h) Min nje puntor i certifikuar per organizimin dhe menaxhimin e kantierit te ndertimit i) Min 1 puntor te certifikuar me ISO 9001 2008 per menagjim te cilesise. j) Min 7 puntor te certifikuar ne lemin e ndertimit si Armirues, Murator, Molerues, Suvatim, Ngrohje, Hidroteknike dhe Elektroteknike.

Per piken J. Te deshmohet me certifikata te lemise se ndertimit te leshuara nga Qendrat e licencuara per aftesim profesional. Per te gjithë puntoret kerkohen kontratat e punes ose parakontrate per kete projekt. Autoriteti kontraktues mban te drejtën e verifikimit te Certifikatave te kerkuara

Oe i shpallur fitues nuk ka dorezur qertifikata siq eshte kerkuar ne dosje te denderit per punntoret nga Qendrat e licencuara per aftesim professional por ka dorezuar Diploma. nuk e plotëson kushtin e AK që OE duhet te dorëzojnë certifikata te lemise se ndertimit te leshuara nga Qendrat e licencuara per aftesim profesional

5. Pretendimi juaj i pestë

Sqarim. Autoriteti Kontraktues konsideron se dorezimi i diplomave ne vend te certifikatave te lemise se ndertimit te leshuara nga Qendrat e licencuara per aftesim profesional nga Operatori Ekonomik nuk perbene kurfare shkelje per arye se keto diploma jane te leshuara nga Qendrat e licencuara per aftesim profesional dhe si te tilla i plotesojne kerkesat e AK njesoj si certifikatat.

AK, konsideron se tenderi juaj është vlersuar me kujdes dhe ka zbatuar me përpikëri rregullat e nxjerra nga KRPP

Drejtori i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.

Adem Duriqi

Drejtor i Prokurimit

